



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1001/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Valon Totaj, me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores S.M nga Gjilani, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av.A.H nga Glllogoci, kundër debitores Qeveria e Kosovës - Ministria e Shëndetësisë - SHSKUK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur më ankesën e kreditores të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1032/2020, të datës 17.09.2020, më datën 30.11.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditores S.M nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1032/2020, i datës 17.09.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1032/2020, të datës 17.09.2020, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitores Qeveria e Kosovës - Ministria e Shëndetësisë – SHSKUK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Prishtinë dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.267/2020, të datës 27.07.2020, të lejuar nga Zyra Përmbartimore - Përmbartuesi Privat I. K, në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditorja përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur ankesë, duke mos i përmendur pretendimet ankimore, me propozim që e njëjta të aprovohet dhe të prishet aktvendimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1032/2020, i datës 17.09.2020, ndërsa urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat P.nr.267/20, i datës 27.07.2020, të mbetet në fuqi si dhe të detyrohet debitori që në emër të përpilimit të ankesës të paguaj shumën prej 208 euro, sipas tarifës së OAK.

Debitorja nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e kreditores.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 17 të LPP, si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

- ankesa e kreditores, **është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitores në bazë të dokumentit përmbarrues - vendimit të Inspektoratit të Punës 01nr.33-232/2020, të datës 05.05.2020, më gjerësisht sikurse në propozimin për përmbarrim. Përmbarruesi Privat me urdhër P.nr.267/2020, të datës 27.07.2020, e ka lejuar propozimin për përmbarrim.

Debitorja me datën 12.08.2020, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditorja me datën 17.08.2020, ka ushtruar përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim ka vendos si në aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1032/2020, të datës 17.09.2020.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e pranuar si të bazuar prapësimin e debitores dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbarrimor P.nr.267/2020, të datës 27.07.2020.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, e përkrah në plotëni Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit pasi që dokumenti përmbarrimor - vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr.33-232/2020-A, i datës 05.05.2020, nuk është i përshtatshëm për përmbarrim, përkatësisht i njëjti nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me LPP për të qenë vendim i përmbarrueshëm, për më tepër që i njëjti nuk e përmban vulën e plotfuqishmërisë, e as atë të përmbarrueshmërisë.

Me nenin 36 par.1 të LPP në mënyrë shprehimore është thënë se “*së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet dhe dokumenti përmbarrues, në origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmeri*”. Ndërsa në nenin 43 par 4 përcaktohet se “*....në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e*

procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim". Në bazë të nenit të sipërcituar del se dokumenti përmbartues - vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr.33-232/2020-A, i datës 05.05.2020, përveç elementëve të tjera të dokumentit përmbartues, i njëjti duhet të këtë edhe vulën e plotfuqishmërisë dhe të përmbartueshmërisë, për me tepër që në shkresat e lëndës gjendet edhe ankesa e debitorës Q. K. U - zyra për çështje juridike, e cila ankesë e ka atakuar dokumentin përmbartues, përkatësisht vendimin e Inspektoratit të Punës 01Nr.33-232/2020-A, të datës 05.05.2020, e që nga kjo ankesë nuk mund të kuptohet se dokumenti përmbartues a është i ndryshuar, i anuluar apo i vërtetuar nga organi i shkallës së dytë në kuadër të Inspektoratit të Punës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore të kreditorit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *"në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1001/2021, me datën 30.11.2021

Gjyqtari,
Valon Totaj